

URDHËR
Nr.568, datë 23.11.2011

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER I SHKENCAVE” TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen në Fakultetin e Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës, të programeve të studimeve të ciklit të dytë “Master profesional” në:

a) E drejtë civile, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master profesional” në “E drejtë civile”;

b) E drejtë penale, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master profesional” në “E drejtë penale”;

c) E drejtë publike, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master profesional” në “E drejtë publike”.

2. Hapjen në Fakultetin e Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës, të programeve të studimeve të ciklit të dytë “Master i shkencave” në:

a) Drejtësi, me profil: civile, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” në “Drejtësi me profil: civile”;

b) Drejtësi me profil: penale, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” në “Drejtësi me profil: penale”;

c) Drejtësi, me profil: publike, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” në “Drejtësi me profil: publike”;

3. Hapjen në Fakultetin e Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës, programin e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” në “Pedagogji e specializuar sociale”, në përfundim, të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master profesional” në “Pedagogji e specializuar sociale”.

4. Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master profesional” realizohen me 90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1.5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik.

5. Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i shkencave” realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike.

6. Programet e studimeve të fillojnë në vitin akademik 2011-2012 dhe brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të jenë plotësuar kushtet, bashkëngjitur këtij urdhri.

7. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

8. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe Universiteti i Tiranës, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj